



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1300/7 prot.

Datë 01/07/2024

V E N D I M
Nr. 775/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01/07/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. **REF-01146-04-12-2024**, me objekt “*Ndërhyrje në muze dhe objekte monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela*”, me fond limit **176,101,389.98** (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e një mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK me NIPT (J84003411K), me adresë: Lushnje, Fier, Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr. 104/18, në zonën kadastrale 3268.

Autoriteti Kontraktor: Operatori ekonomik "INA" SHPK me NIPT (J61814009W), me adresë: Tiranë, Rruga "Besim Imami", "Myslym Shyri", Mbrapa Karburantit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me adresë: Rruga "Sami Frasheri", nr. 10, Tiranë

Subjekt i interesuar: BOE "C O L O M B O" SHPK, NUIS J82916489E, me adresë; Lagjja "Kryengritja e Fierit", Rruga "Vangjel Rrushku", godina nr. 67, Fier & "BAJRAMI N" NUIS K02727202O, me adresë Elbasan Labinot, fushë XIBRAKË, Rruga Elbasan Xibrakë, km. 13, zk. 3864, pasuritë nr.734/1+732+738/9.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit

kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.04.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. **REF-01146-04-12-2024**, me objekt “Ndërhyrje në muze dhe objekte monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela”, me fond limit **176,101,389.98** (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e një mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 30.04.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 16.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “C O L O M B O” ShPK, NUIS J82916489E &” BAJRAMI N” ShPK NUIS K02727202O, vlera 121,177,555 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra - 268,00

2. BOE “BEAN” ShPK NUIS J72510445Q & "SARDO" ShPK NUIS K13120402W, vlera 125,085,215.57 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra - 264,60

3. BOE “B93 II” ShPK NUIS L52209050O & “B-93” ShPK, NUIS J 62903508 R & “BEQIRI” Sh.p.k NUIS J98624801V, vlera 130,027,617.5 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra - 262,80

4. BOE “LIS KONSTRUKSION”ShPK NUIS K66613407H & “VIANTE Konstruksion” ShPK NUIS K47103804L, vlera 139,454,733.31 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 254,10

5. OE BE - IS SH.P.K NUIS K71412003A vlera 136,535,298 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 239,40

6. OE "ED KONSTRUKSION" NUIS K61625001I, vlera 133,379,468 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 238,80
7. OE "LLAZO" NUIS K24218401K vlera 138,087,026, lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 238,80
8. OE "SENKA" NUIS J94808405Q vlera 139,120,735 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 236,10
9. OE "FLED" NUIS K17621104C vlera 130,101,652.5 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 235,80
10. OE "DION-AL" ShPK, NUIS K67917301H vlera 143,011,078.25 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 232,20
11. OE "ALBA KONSTRUKSION" ShPK NUIS J61812013R, vlera 136,230,644.19 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 223,50
12. OE "RAFIN COMPANY" ShPK NUIS L52125110A, vlera 138,485,363 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 209,40
13. OE "DESARET COMPANY" ShPK NUIS K01816001J, vlera 148,334,813.82 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 198,30
14. OE "LEON KONSTRUKSION" ShPK NUIS K71820009I, vlera 153,012,545.05 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 196,20
15. OE "ALB-BUILDING" ShPK NUIS J69102508C, vlera 158,460,783.75 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 189,00
16. OE "KEVIN KONSTRUKSION" NUIS K71401004Ë, vlera 150,136,149.88 lekë pa TVSh totali i pikëve të marra 186,40
- 17. OE "INA" ShPK NUIS J61814009W, vlera J61814009W, vlera 125,000,183.8 lekë pa TVSh (Skualifikuar)**
18. OE "S I R E T A 2F" ShPK NUIS K51501008J, vlera 111,111,111 lekë pa TVSh (Skualifikuar)
19. BOE "I.D.K – KONSTRUKSION "SHPK NUIS K51408016J & T&XH SHPK NUIS L72121504I, vlera 132,640,680.25 lekë pa TVSh (Skualifikuar)
- 20. OE "Z D R A V A" ShPK NUIS J84003411K vlera 119,119,039 lekë pa TVSh (Skualifikuar)**
21. OE "ZEQILLARI"ShPK NUIS L61912024O nuk ka ngarkuar në sistemin elektronik, dokumentacionin e kërkuar sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit. (Skualifikuar)
22. OE "DAJTI PARK 2007" ShPK NUIS K11507003S, vlera 114,465,965 lekë, pa TVSh (Skualifikuar)

II.4. Në datën 20.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim - Fituesi Paraprak", për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 27, datë 27.05.2024.

II.5. Operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

1.- "Operatori ekonomik "Zdrava" ShPK nuk ploteson Kriterin për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1. te Kriteve të Vecante ne DST per objektin "Ndërhyrje në muze dhe objekte

monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela” per sa i perket "Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht, ky operator ekonomik nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme sipas kriterit a- me nje kontrate te vetme ne vleren 50% te fondit limit (88,050,694.99 lekë pa TVSh). Per te plotesuar kete kusht operatori ekonomik ka paraqitur nje kontratë me objekt “Ndertimi i njesive te banimit ne ndertesa per zonen e re per zhvillim Kavaje” te lidhur me autoritetin kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe për të cilën ka paraqitur shtojcën 9 “Formularin e Vleresimit” me një vlerësim realizim jo i mire i punimeve. Kjo kontrate e zbatuar nga ky operator ekonomik, pjese e nje bashkimi operatoresh ekonomik, lidhur me FSHZH ne kuader te programit te Rindertimit ka pasur problematika te theksuara me cilesine e punimeve (riparimin e disahershem te defekteve gjate zbatimit te kontrates por edhe gjate periudhes se garancise), mungesen e profesionalizmit dhe komunikimit gjatë zbatimit te kontratës dhe mospërbushjen e afatit sipas grafikut të kërkuar për të dorëzuar në kohë veprën publike, duke shkaktuar vonesa në dorëzimit e përfituesit direkt të kësaj vepre publike (banoret e prekur nga termeti).

Sipas përcaktimit të nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në vendosjen e kërkesave të vecanta për kontratat për punë publike, autoritetet apo entet kontraktore, si dëshmi për përvojën e mëparshme, mund të kërkojnë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në këtë kuadër, Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar dokumentet standarde të prokurimit për punët publike, ku në vecanti ka përfshirë Shtojcën 9 – Formular Vlerësimi (procedurë e hapur – punë). Nga shqyrtimi i kujdesshëm i këtij dokumenti vërehet se APP ka përcaktuar që ky formular të shoqërohet me Aktin e Kolaudimit dhe situacionet përkatëse. Po ashtu, përveç rubrikave ku saktësohen vlera, afati, përmbushja apo jo, etj. formulari standart përmban edhe rubrikën “Vlerësimi”, rubrikë e cila kërkohet të plotësohet “me fjalë” nga Autoriteti/Enti Kontraktor. KVO konsideron se në përgjithësi, referencat (formularët e vlerësimit) luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e përzgjedhjes së kontraktorit, duke ofruar njohuri të vlefshme që informojnë vendimet për punësim/angazhim/kontraktim dhe kontribuojnë në rezultate të suksesshme të projektit. Lëshimi i një reference (formular vlerësimi) për një kontraktor të mëparshëm shërben për disa qëllime, ndër të cilat konsiderojmë se janë:

1. Konfirmimi i Aftësive dhe Përvojës: Referencat ndihmojnë në konfirmimin/verifikimin e aftësive, përvojës dhe ekspertizës së kontraktorit. Ato u ofrojnë autoriteteve/enteve

kontraktor apo punëdhënësve njohuri mbi aftësitë e kontraktorit dhe performancën e tij të mëparshme në projekte të ngjashme.

2. Vlerësimi i Cilësisë së Punës: Referencat lejojnë autoritetet/entet kontraktore ose punëdhënësit të vlerësojnë cilësinë e punës së kontraktorit. Ato mund të tregojnë për kujdesin ndaj detajeve të kontraktorit, përmbushjen e specifikimeve të projektit dhe aftësinë për të ofruar rezultate sipas pritshmërive.

3. Vlerësimi i Profesionalizmit dhe Komunikimit: Referencat mund të hedhin dritë mbi profesionalizmin e kontraktorit, aftësitë e tij në komunikim dhe aftësinë për të bashkëpunuar efektivisht me autoritetet/entet kontraktore, anëtarët e ekipeve apo/dhe palët e interesuara (njësi të vetëqeverisjes vendore, përfitues direkt, etj). Këto informacione ndihmojnë në vlerësimin e mënyrës së integritetit të kontraktorit në ekipet e projektit dhe në ndërveprimin me autoritetet/entet kontraktore.

4. Zbutjen e rrezikut (Risk mitigation): Duke kërkuar dhe marrë referencat, autoritetet/entet kontraktore ose punëdhënësit mund të reduktojnë rrezikun e lidhur me kontraktimin/punësimin e një kontraktori. Njohja për performancën e mëparshme të kontraktorit, besueshmërinë dhe aftësinë për të përballuar sfidat mund të informojnë vendimet për kontraktim/punësim dhe të zvogëlojnë mundësinë e pengesave apo mospërmbushjes së projektit.

5. Ndërtimi i Besimit: Referencat pozitive ndërtojnë besim në aftësitë dhe përshatshmërinë e kontraktorit për objektine punës/projektin. Ato u rikthejnë autoriteteve/enteve kontraktore ose punëdhënësve sigurinë se po marrin një vendim të arsyeshëm duke përzgjedhur dhe kontraktuar shërbimet e duhura të një kontraktori.

Për sa më sipër, duke pasur parasysh se ligjvënësi dhe autoritetit rregullator kanë përcaktuar kërkesën për referenca (formular vlerësimi), të shoqëruar me akte koluadimi, ku janë përfshirë minimalisht kërkesat për vlerën dhe afatin e përfundimit të kontratës, natyrën e punës së bërë, si dhe situacionet përkatëse, deduktohet se rubrika “Vlerësimi” i lihet autoriteteve/enteve kontraktore të plotësohet. Në këtë plotësim autoritetet/entet kontraktore kanë parasysh pikërisht vlerësimin e cilësisë së punimeve të kryera, pra minimalisht qëndrueshmërinë e këtyre punimeve dhe mospasjen e nevojës për përsëritjen dhe ribërjen e këtyre punimeve, jo vetëm gjatë periudhës së kontratës por edhe për mosbërjen e disahershme të riparimeve të të njëjtave punime, vlerësimin e profesionalizmit dhe komunikimit gjatë afatit të kontratës dhe përmbushjen e këtij afati sipas grafikut të kërkuar për të dorëzuar në kohë veprën publike, apo shmangien e rrezikut të vonësës së dorëzimit të përfituesit direkt të kësaj veprë publike duke shmangur nisjen apo nxitjen e problematikave sociale përveç atyre ekonomike, si dhe aspekte të tjera të cilat nuk arrihet të artikulojnë qartësisht në dokumenta si akti i koluadimit apo situacionet.

Ne kete kuader, AK FSHZH konsideron se meqenese ligjvenesi ka kerkuar qe pervec dokumenteve si kontrata, akt koluadimit, faturat dhe/apo situacionet, punimet e ngjashme te shoqerohen me formular vleresimi, ne te cilin shprehet cilesia e punimeve; dhe nese ky vleresim nuk eshte pozitiv, operatori ekonomik, ne kete rast Zdrava sh.p.k, nuk krijon besueshmerine e nevojshme per zbatimin e kontrates dhe si e tille kjo kontrate me vleresim negativ nuk duhet te merret parasysh. Duke mos marre parasysh

kete kontrate OE "Zdrava" nuk ploteson kushtin a) si me siperpermendur dhe gjithashtu as sipas kriterit b) ne vleren e dyfishit te fondit limit (352,202,779.96) me shume kontrata, pasi kontratat e ngjashme nuk arrijne vleren e kerkuar.

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Sa më siper Operatori Ekonomik "Zdrava" ShPK skualifikohet!

II.5.1. Në datën 23.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2024/4115 dhe me nr. 1300/2024 prot., datë 23.05.2024, e operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor, në arsyet e skualifikimit, citon se kontratat e ngjashme nuk arrijne vlerën e kërkuar.

Në përmbushje të kërkesave të pikës 2.3.1 të Kriterëve të Vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit, në këtë procedurë, ne kemi paraqitur disa kontrata të ngjashme, për plotësimin e kriterit b) në vlerën e dyfishit të fondit limit (352,202,779.96 leke pa TVSh), si më poshtë:

- 1. Rikonstrukcion i shkolles se mesme Muhamed Kondi" Polican, 42,688,523.6 leke pa TVSh.*
- 2. Rikonstrukcion Bujtinash per Agroturizem", 44,752,038.33 leke pa TVSh.*
- 3. Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara, Belsh,19,181,225 leke pa TVSh.*
- 4. Restaurim, Pershtatje dhe Rijetezim i Baneses Kategori II, me kod arkive G-071, Gorice,Berat, 34,329,388.8 leke pa TVSh.*
- 5. Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara, Berat, 38,173,678.7 leke pa TVSh.*
- 6. Rikonstrukcion i konviktit te djemve te shkolles Kristo Isak", Berat, 21,364,517.54 leke paTVSh.*
- 7. Adaptim i dy godinave ekzistuese, Cerrik, 30,190,436.66 leke pa TVSh.*
- 8. Rehabilitim/Perforcim banesash ekzistuese", Cerrik, 26,920,399.16 leke pa TVSh.*
- 9. Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara,*

Berat,9,447,871

leke pa TVSh.

10. Rikonstruksion objekti 2kt dhe ndryshim destinacioni nga Magazine ne banesa sociale,Cerrik, 11,361,879 leke pa TVSh.

11. Rikonstruksion i ish kinemase Poshnje, per salle mbledhjesh, Ura Vajgurore, 5,162,349.25leke pa TVSh.

12. Nderhyrje per stabilizimin e carjeve ne shkollen e mesme Dilaver Nezha”, Qukes”Prrenjas, 28,767,375 leke pa TVSh.

13. Rikonstruksion i objektit 5kt bar restorant, administrate”, Lushnje, 15,500,000 leke pa TVSh.

14. Ndertim shtese kati ne objekt ekzistues per strehim social”, Kucove, 18,640,629.16 leke paTVSh.

15. Rikualifikimi i qendres kulturore Aleksander Moisiu, Kavaje, 19,155,215.8 leke pa TVSh.

16. Rikualifikim i rruges se shkolles dhe ndertimi i parkut, Roskovec, 19,294,887.06 leke paTVSh..

Këto kontrata të ngjashme, arrijnë vlerën e 200% të fondit limit, përkatësisht me vlerë 384,930,414.06 lekë pa TVSh.

Duket qartë se nga kontratat e paraqitura nga ne, plotësohet vlera e kërkuar 200% e fondit limit. As në arsyetimin e dhënë nga KVO e Autoritetit Kontraktor, nuk është bërë një analizë e plotë, secilat punë të ngjashme të paraqitura nga ana jonë, janë llogaritur për përmbushjen ose jo të kriterit

b) me vlerë 200% të fondit limit, pasi sikurse kemi paraqitur më sipër, vlera totale e punëve të ngjashme të ngarkuara në sistemin e prokurimit publik, është 384,930,414.06 lekë pa TVSh. Kjo vlerë e kontratave të ngjashme përmbush kriterin 2.3.1. pika b) të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Përsa I përket elementeve kohë dhe natyrë e ngjashme,

gjenden në të gjitha kontratat e punëve të ngjashme të paraqitura nga shoqëria jonë. Kontrata objekt prokurimi, nuk ka as natyrë as kompleksitet apo metodologji të ndryshme, nga të gjitha kontratat e realizuara nga ana jonë dhe të paraqitura si të ngjashme në këtë procedurë prokurimi(Punime rikonstruksioni).

Por, në arsyen e skualifikimit, thjeshtë citojne frazën OE Zdrava” nuk ploteson kushtin a) si me siperpermendur dhe gjithashtu as sipas kriterit b) ne vleren e dyfishit te fondit limit (352,202,779.96) me shume kontrata, pasi kontratat e ngjashme nuk arrijnë vlerën e kërkuar. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga

kandidati ofertues .

Ky vleresim i bërë nga KVO, nuk është aspak profesional, është i pambeshtetur në ligj dhe totalisht në kundërshtim me frymën dhe parimet e Ligjit të Prokurimit Publik, pasi kontratat e paraqitura nga ne jo vetëm plotësojnë vlerën e 200% të fondit limit në vlerë por edhe natyrën e punës së ngjashme.

Autoriteti kontraktor ka cënuar rëndë parimet e sanksionuara në Ligjin nr.162/2020, Për Prokurimin Publik neni 2 i cili shpreh qëllimin e këtij ligji : a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktor nuk e ka marrë mundimin të shohë të gjitha kontratat e ngjashme të paraqitura nga ne, për të verifikuar përmbushjen e kriterit të punës së ngjashme, por është kapur vetëm me një të një nga kontratat e ngjashme konkretisht Ndertimi i njesive të banimit në ndertesa për zonen e re për zhvillim Kavaje”, të lidhur me autoritetin kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me formularin e vlerësimit Shtojcën 9, të paraqitur nga shoqëria jonë. KVO arsyeton, se ka patur problematika të theksuara me cilësinë e punimeve (riparimin e disahershem të defekteve gjatë zbatimit të kontrates, por edhe gjatë periudhës së garancisë), mungesën e profesionalizimit dhe komunikimit gjatë zbatimit të kontratës dhe mospërmbushjen e afatit sipas grafikut të kërkuar për të dorëzuar në kohë veprën publike. I bëjmë me dije Autoritetit Kontraktor Fondit Shqiptar të Zhvillimit, se të gjitha komunikimet janë bërë në mënyrë zyrtare me profesionalizëm dhe për çdo defekt të konstatuar janë marrë masa brenda vlerës së preventivit. E vetmja arsye për të cilën formulari i vlerësimit shprehet realizimin jo i mirë i punimeve” është për faktin e elementit kohë pra vonesës së realizimit në kohë të punimeve. Për këtë fakt kemi zhvilluar komunikime zyrtare me Autoritetin Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ku janë dhënë arsyet e vonesës, arsye të cilat kanë qenë aplikimi për Ndryshim PDV dhe rishikim projekti Arkitektonik me kërkesë të Autoritetit Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pandemia Covid-19 e cila solli gjendjen e jashtëzakonshme globale, ku u përballëm me padisponueshmërinë e plotë të stafit teknik dhe Kriza që preku ndjeshëm disa nga materialet themelore të ndërtimit si: hekur, cemento, tullë etj, Rritja e kërkesës për produktet në fjalë dhe mos plotësimi i nevojave të tregut, bëri që këto produkte të arrinin vlera ekstreme, vlera të cilat i tejkalonin cmimet e manualeve të vendosura nga Shteti Shqiptar.

Fenomen ky i cili vështirësoi blerjen e këtyre produkteve, duke na detyruar të zgjasim ditët për mundësimin e uljeve të cmimeve, apo vendosjen e një Cmimi Tavan nga Shteti Shqiptar. Në vijim me hyrjen në fuqi të aktit normativ nr. 10 date 18/05/2022, Për kompensimin financiar të cmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022” neni 8, paragrafi 2,

Dispozita Kalimtare, citohet Vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky aktnormativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në process zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penaltete ndaj operatorëve ekonomikë”. Pra theksojmë së ky vlerësim ka ardhur vetëm për arsye të afateve dhe jo për arsye e tjera të përmendura nga ju, fakt të cilin e vërteton dhe Akti I Kolaudimit si dhe certifikata e Marrjes në Dorëzim nga ju. Nëse do ishin këto problematika të pretenduara nga ana juaj, a mundet që grupi teknik të marri në dorëzim objektin? Sigurisht që nuk mundet!

Duam të vemë në vëmendjen tuaj që pjesë e paketës B të rindërtimit, ka qënë edhe operatori i kualifikuar i pari nga ju C O L O M B O” ShPK, ku ka marrë penaltete për mosrealizimin në kohëtë punimeve, por mesa duket nuk ju intereson tja vini në dukje dhe ta skualifikoni me këtë motiv, sikurse bëttë me shoqërinë tonë. Ndaj kësaj kompanie të cilës doni ti jepni besimin tuaj” për realizimin e kësaj kontrate, janë marrë penaltete nga Bashkia Lushnje ku i është zgjidhur kontratapër punë publike për shkelje të rënda të zbatimit të kontratës, informacion i cili mund të aksesohet lehtësisht nga Komisioni I Prokurimit Publik.

Përfundimisht theksojmë se kontratat e paraqitura si të ngjashme për këtë objekt prokurimi plotësojnë kriterin 2.3.1 pika b) Punë e ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera,e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi I vlerës limit që prokurohet.”dhe arsyeja e skualifikimit nga ana e Autoritetit Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk qëndron.

Rezulton qartësisht e provuar se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për hartimin e dokumenteve të procedurës së konkruuese , në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai është përgjegjës, përvec hartimit të dokumenteve të procedurës konkruuese dhe për përcaktimin e kërkesave për kualifikim si dhe përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Ligji nr.162/2020,Për Prokurimin Publik neni 2 i cili shpreh qëllimin e këtij ligji parashikon:Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimitpublik.*

Shkeljet e Autoriteti Kontraktor cënojnë dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve

të padrejta të organeve të pushtetit nga njera anë dhe si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve pa siguruar respektimin e procedurave ligjore nga ana tjetër.

Procesi i rregullt ligjor është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës.

GJykata Kushtetuese në vendimin 10/07 arsyeton se “E drejta për një proces të rregullt ligjor nënkupton të drejtën për të garantuar shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt ose procedurë e administratës shtetërore, ku përfshihen dhe veprimet e mosveprimet në kundërshtim me ligjin...”

Parimi i procesit të rregullt ligjor në veprimtarinë administrative pra përfaqëson thelbin e garancivedhe të efektivitetit të të drejtave të qytetarëve në përballjen e tyre me administratën publike.

Veprimet e mësipërme vijjnë në kundërshtim dhe me nenin 258 të K.Penal, i cili parashikon se: Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Format e kryerjes së kësaj vepre penale nga ana objektive janë dy:

1) pengimi i palëve për të marrë pjesë në tender/ankand dhe 2) vlerësim i pabarabartë i një kushti/disa kushteve të plotësuar nga të gjitha palët.

Pra, vlerësimi i mësipërm është bërë qëllimisht nga Autoriteti Kontraktor, që pjesëmarrësit të mos jenë në kushte të barabarta konkurrimi, duke sjellë favorizimin e një operatori ekonomik dhe skualifikimin e operatorit tjetër, në këtë rast skualifikim e shoqërisë sonë. Nga ana subjektive kjo veprë kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, nisur nga interesat materiale ose morale.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik dhe VKM nr.285 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik kërkojmë:

- Pezullimin e procedurës së prokurimit derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht
- Kualifikimin e shoqërisë Z D R A V A” ShPK, si operator i suksesshëm në këtë procedurë prokurimi.”.

II.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1300/2 prot., datë 24.05.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ZDRAVA” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1300/2024 prot., datë 23.05.2024.

II.5.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 2122 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1300/3 prot., datë 06.06.2024, me objekt “Vendim” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.5.4. Njëpërmjet shkresës me nr. 2122 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1300/4 prot., datë 06.06.2024, me objekt “Vendim” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.6. Operatori ekonomik “INA” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Operatori ekonomik “Ina” ShPK, nuk ploteson Kriterin për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1. te Kriteve të Vecante ne DST per objektin “Ndërhyrje në muze dhe objekte monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela” per sa i perket "Përvojës së sukseshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht, ky operator ekonomik nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme sipas kriterit a- me nje kontrate te vetme ne vleren 50% te fondit limit (88,050,694.99 lekë pa TVSh) pasi nuk ka paraqitur asnje punë të ngjashme në këtë vlerë dhe as sipas kriterit b) ne vleren e dyfishit te fondit limit (352,202,779.96) me shume kontrata, pasi kontratat e ngjashme nuk arrijne vlerën e kërkuar. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Sa më siper Operatori Ekonomik “Ina” ShPK skualifikohet!

II.6.1. Në datën 24.05.2024, njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2024/4118 dhe me nr. 1310/2 prot., datë 27.05.2024, e operatorit ekonomik “INA” SHPK, për procedurën e prokurimit, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik INA ShPK e rrezon kete pretendim per arsyet e mëposhtme: 1. Ne baze te ligjit te Prokurimit Publik Nr. 162/2020 operatori ekonomik duhet te permbushë kriteret teknike per "Pervojen e sukseshme ne realizimin e puneve te ngjashme" e cila percaktohet:a) Pune te ngjashme per nje objekt te vetem jo me te vogel se 50% e vleres se perlllogaritur te

kontrates ge prokurohet ose b) Pune te ngjashme deri ne nje kufi ku viera monetare totale e puneve te kryera giate pese viteve te fundit ishte jo me e vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates ge prokurohet. Qenje punim te quet i ngjashem ai duhet te jete: a) brenda afatit (elementi kohe), b) duhet te plotesoje madhesine e kerkuar (elementi vlere) dhe c) duhet te jene te ngjashem me objektin qe prokurohen (elementi natyre e ngjashme). a) Se pari, Operatori ekonomik INA ShPK ka zgjedhur te paraqitet me objektivin duke grumbulluar shumicen e punimeve te ngjashme te cilat kanë perfunduar. Duke versuar ge nje punim i ngjashem duhet teplotesojenj nga kriteret baze, elementin kohe, cilesojme se punimet e ngjashme te kompanise sone jane te gjitha brenda afatit qe percaktohet nga ligji i prokurimit publik. b) Se dyti, duke marre parasysh elementin vlere, theksojme, se duke i mbledhur te gjitha punimet e marra se bashku arrihet nje total prej 385,000,000 leke, vlere kjo, e cila sipas kerkeses nga autoriteti kontraktor e tejkalon vlerin e dyfishit te fondit imit, 352,202,779.96 leke. Theksomje, se dhe ky kriter permbushet dhe tejkalohe nga operatori ekonomik.

c) Së treti, nënpika e këtij kriteri ka lidhje me elemntin e natyrës së ngjashme të punimeve. Theksojmë se, me element natyre të ngjashme lidhet kompleksiteti në përgjithësi i zërave të punimeve, të cilët duhet të jenë të ngjashëm me natyrën e zërave të punimeve të objektit që prokurohet. Ne si shoqëni kemi bërë një analizë të gjerë të shumicës kryesore të zërave tobjektit të prokurimit dhe dalim në konkluzionin se sasia e zërave të marrë sëbashku nga të gjithë punimet e ngjashme tekjalojnë disa herë zërat e punimeve të preventivit për objektin që prokurohet. Bashkangjitur do t'ju përcjellim dhe një tabelën në lidhje me krahasimin e zërave në preventivat, në të cilën duket qartë se zërat e punëve të ngjashme te realizuara janë në një sasi më të madhe se zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen. Duke analizuar se shoqëria INA ShPK i ka përmbushur të gjitha këto nënpika për "Përvojën e sukseshme në realizimin e punëve të ngjashme", atëhere ne e rrëzojmë si pretendim vendimin e KVO dhe kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë për këtë procedurë prokurimi dhe vlerësimin me pikë nga ana e komisionit.

II.6.2. Më datë 27.05.2024, nëpërjet sistemit elektronik, operatori ekonomik ankimues "INA" SHPK, ka paraqitur Formulën e argumenteve, protokolluar me tonin me nr. 1310/3 prot., datë 27.05.2024.

II.6.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1310/4 prot., datë 27.05.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "INA" SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1310/2024 prot., datë 27.05.2024.

II.6.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 2128 prot., datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1310/5 prot., datë 06.06.2024, me objekt "Vendim", dërguar me shërbim postar, është

depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.6.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 2128 prot., datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1310/6 prot., datë 06.06.2024, me objekt “Vendim”, dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomië ankimues “ZDRAVA” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....Konkretisht, ky operator ekonomik nuk ploteson kriterin për punë të ngjashme sipas kriterit a- me një kontratë të vetme në vlerën 50% të fondit limit (88,050,694.99 lekë pa TVSh). Për të plotësuar këtë kusht operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë me objekt “Ndertimi i njesive të banimit në ndertesa për zonën e re për zhvillim Kavaje” të lidhur me autoritetin kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe për të cilën ka paraqitur shtojcën 9 “Formularin e Vleresimit” me një vlerësim realizim jo i mirë i punimeve. Kjo kontratë e zbatuar nga ky operator ekonomik, pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomik, lidhur me FSHZH në kuader të programit të Rindertimit ka pasur problematika të theksuara me cilësinë e punimeve (riparimin e disahershem të defekteve gjatë zbatimit të kontratës por edhe gjatë periudhës së garancisë), mungesën e profesionalizmit dhe komunikimit gjatë zbatimit të kontratës dhe mospërmbushjen e afatit sipas grafikut të kërkuar për të dorëzuar në kohë veprën publike, duke shkaktuar vonesa në dorëzimit e përfituesit direkt të kësaj veprë publike (banoret e prekur nga termeti).....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika .2.3/ “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt - kolaudimi;

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

	ZDRAVA SHPK			
N r.	PUNE TE NGJASHME	Vlera pa TVSH		
1	Kontratë bashkëpunimi , midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & "ZDRAVA" SHPK me datë 21.09.2022, ku operatori ekonomik “BAJRAMI N” SHPK do të realizojë 5% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK do të realizojë 95% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur,			
	Kontratë me nr. 2600 prot., datë 25.10.2022 me objekt “Rikonstruksioni i shkollës së mesme Muhamed Kondi Polican”, lidhur midis	xxxxxxxx	me TV Sh	

	bashkimi i operatorëve ekonomikë "BAJRAMI N" SHPK & "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh			
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 1447/1 prot., dhe me datë 29.05.2023			
	Akt - kolaudimi me nr. 1447 prot., me datë 26.05.2023			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Polican, për bashkimin e operatorëve ekonomikë "BAJRAMI N" SHPK & "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Muhamed Kondi Polican", data e fillimit të kontratës 01.11.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 03.04.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "BAJRAMI N" SHPK & "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr. 983/2022 datë 22.11.2022, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 185/2023 datë 30.03.2023, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 331/2023 datë 16.05.2023, "ZDRAVA" SHPK			
2	Kontratë me nr. 2582 prot., datë 18.09.2018 me objekt "Ndërhyrje për stabilizimin e carjeve në shkollën e mesme Dilaver Nezha Qukës", lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Prrenjas, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 1939 prot., dhe me datë 29.06.2019			
	Certifikat e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve me nr. 3528 prot., dhe me datë 21.12.2022			
	Akt - kolaudimi me datë 28.06.2019			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Prrenjas, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “Ndërhyrje për stabilizimin e carjeve në shkollën e mesme Dilaver Nezha Qukës”, data e fillimit të kontratës 03.10.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 20.03.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxx	me TV Sh	xxxx
	Faturë tatimore nr. 30 datë 18.10.2018, “ZDRAVA” SHPK	xxx		
	Faturë tatimore nr. 41 datë 03.03.2019, “ZDRAVA” SHPK	xxxx		
	Faturë tatimore nr. 46 datë 27.06.2019, “ZDRAVA” SHPK	xxxx		
3	Kontratë me nr. 2438 prot., datë 30.03.2021 me objekt “Rikualifikim i rrugës së shkollës dhe ndërtim i parkut”, lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Roskovec, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 21.10.2022			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 05.05.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Roskovec, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “Rikualifikim i rrugës së shkollës dhe ndërtim i parkut”, data e fillimit të kontratës 30.03.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 31.01.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 244/2022 datë 24.03.2022, “ZDRAVA” SHPK			

4	Kontratë me nr. 208/15 prot., datë 01.04.2021 me objekt <i>“Rikonstruksion i ish kinemasë Poshnje, për sallë mbledhjesh”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TV Sh	
	Certifikat garancie me nr. 252/2 prot., datë 26.01.2023			
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me nr. 3981 prot., me datë 09.12.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me nr. 2382/2 prot., me datë 18.10.2021			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Ura Vajgurore, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rikonstruksion i ish kinemasë Poshnje, për sallë mbledhjesh”</i> , data e fillimit të kontratës 20.05.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 20.07.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxxx	me TV Sh	xxxxxx
	Faturë tatimore nr. 193/2021 datë 16.12.2021, <i>“ZDRAVA”</i> SHPK			
5	Kontratë me nr. 4844 prot., datë 27.09.2022 me objekt <i>“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Berat, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 20.09.2023			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me nr. 4216 prot., me datë 21.08.2023			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “Përmirësim i banesave ekzsituose për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, data e fillimit të kontratës 27.09.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 23.05.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr. 2002 datë 20.01.2023, “ZDRAVA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 1388 datë 22.06.2023, “ZDRAVA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 10449 datë 30.09.2023, “ZDRAVA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 228 datë 07.04.2023, “ZDRAVA” SHPK			
6	Kontratë me nr. 465 prot., datë 16.05.2019 me objekt “Rikonstruksioni i konviktit të djemve të shkollës Kristo Isak -Berat”, lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Berat, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 10.12.2019			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 31.10.2019			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksioni i konviktit të djemve të shkollës Kristo Isak -Berat”, data e fillimit të kontratës 16.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 16.08.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 10 datë 13.07.2019, “ZDRAVA” SHPK			

	Faturë tatimore nr. 13 datë 13.08.2019, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 4 datë 11.12.2019, "ZDRAVA" SHPK			
7	Kontratë me nr. 3246 prot., datë 20.09.2019 me objekt "Adaptim i dy godinave ekzistuese", lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Cërrik, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me nr. 2111/1 prot., me datë 11.08.2020			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Cërrik, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Adaptim i dy godinave ekzistuese", data e fillimit të kontratës 03.012.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 30.06.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr.08 datë 01.07.2020, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr.114 datë 11.12.2020, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr.11 datë 01.09.2020, "ZDRAVA" SHPK			
8	Kontratë me nr. 3104 prot., datë 10.10.2022 me objekt "Ndërtim shtesë kati në objekt ekzistues për strehim social", lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Kucovë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 06.06.2023			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 24.05.2023			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kucov, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Ndërtim shtesë kati në objekt ekzistues për strehim social</i> ”, data e fillimit të kontratës 18.10.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.02.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr.489/2023 datë 06.07.2023, “ZDRAVA” SHPK			
9	Kontratë me nr. 3756/10 prot., datë 22.09.2020 me objekt “ <i>Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Berat, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 28.06.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara</i> ”, data e fillimit të kontratës 02.10.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 02.12.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr.1/2021 datë 08.03.2021, “ZDRAVA” SHPK			
10	Kontratë me nr. 2160 prot., datë 08.10.2020 me objekt “ <i>Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara, Bashkia Belsh</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Berat, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TV Sh	

	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 01.06.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me nr. 1726 prot., me datë 27.05.2021			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat, për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara, Bashkia Belsh", data e fillimit të kontratës 05.11.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.03.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxxx	me TV Sh	xxxxxx
	Faturë tatimore nr.24 datë 09.12.2020 "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr.13/2021 datë 27.05.2021, "ZDRAVA" SHPK			
11	Kontratë me nr. 2544 prot., datë 29.09.2020 me objekt "Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese", lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Cërrik, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 30.12.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Cërrik për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese", data e fillimit të kontratës 05.10.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 03.12.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxxx	me TV Sh	xxxxxx
	Faturë tatimore nr.9/2021 datë 20.10.2021, "ZDRAVA" SHPK			

	Faturë tatimore nr.3/2021 datë 18.10.2021, "ZDRAVA" SHPK			
12	Kontratë me nr. 2416 prot., datë 16.09.2020 me objekt "Rikonstruksion objekti 2kt dhe ndryshim destinacioni nga Magazinë në Banesa Sociale", lidhur midis operatorit ekonomik "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Cërrrik, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë e marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 26.02.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 10.02.2021			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Cërrrik për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion objekti 2kt dhe ndryshim destinacioni nga Magazinë në Banesa Sociale", data e fillimit të kontratës 16.09.2020 data e mbarimit të punimeve të kontratës 01.01.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxxx	me TV Sh	xxxxxx
Faturë tatimore nr.7/2021 datë 01.04.2021, "ZDRAVA" SHPK				
13	Kontratë bashkëpunimi me nr. rep 2952 nr.kol 1119, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "BAJRAMI N" SHPK & "ZDRAVA" SHPK me datë 11.08.2020, ku operatori ekonomik "BAJRAMI N" SHPK do të realizojë 49% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK do të realizojë 51% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur			
	Prokurë e posaçme me nr. rep 2953, nr. kol 1120 datë 11.08.2020			

	Kontratë me nr. 3224 prot., datë 15.12.2020 me objekt “Rindërtim i njësisve të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, lidhur midis bashkimi i operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	pa TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 31.12.2021			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 17.12.2021			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për bashkimin e operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “Rindërtim i njësisve të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, data e fillimit të kontratës 28.01.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.09.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Realizim jo i mirë i punimeve. E përmbushur: PO	xxx xxx	pa TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr. 270/2022 datë 06.04.2022, “ZDRAVA” SHPK			
14	Kontratë bashkëpunimi me nr. rep .1480 nr.kol .701, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “Dulla Konstruksion” SHPK & "ZDRAVA" SHPK me datë 01.04.2021, ku operatori ekonomik “Dulla Konstruksion” SHPK do të realizojë 44% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK do të realizojë 56% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur			

	Kontratë me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021 me objekt <i>“Rikualifikim i qendrës kulturore Aleksandër Moisiu”</i> , lidhur midis bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dulla Konstruksion” SHPK & "ZDRAVA" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 04.02.2022			
	Certifikatë i marrje përfundimtare në dorëzim të punimeve, nr. 4987/1 prot., me datë 16.10.2023			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 03.02.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë, për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Dulla Konstruksion” SHPK & "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rikualifikim i qendrës kulturore Aleksandër Moisiu”</i> , data e fillimit të kontratës 04.06.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 31.01.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dulla Konstruksion” SHPK & "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: e përmbushur me sukses.	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr. 258/2021 datë 29.09.2021, “Dulla Konstruksion” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 478/2021 datë 26.10.2021, “Dulla Konstruksion” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 80/2022 datë 10.02.2022, “Dulla Konstruksion” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 260/2022 datë 07.03.2022, “Dulla Konstruksion” SHPK			
15	Kontratë Sipërmarrje me datë 25.04.2020 me objekt <i>“Rikonstruksion i objektit 5 kt bar restorant, administratë, pjesë e objektit ekzistues “Pikë karburanti, bar restorant, administratë 5 kt”</i> , lidhur midis sipërmarrësit "ZDRAVA" SHPK dhe investitor "Bashkimi/L" SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje e në dorëzim të punimeve me datë 20.02.2022			

	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 05.02.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga Investitor "Bashkimi/L" SHPK për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion i objektit 5 kt bar restorant, administratë, pjesë e objektit ekzistues "Pikë karburanti, bar restorant, administratë 5 kt", data e fillimit të kontratës 24.04.2020 data e mbarimit të punimeve të kontratës 24.05.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr.11 datë20.12.2020, "ZDRAVA" SHPK			
16	Kontratë Sipërmarrje me nr. 124 Rep, nr. 54 Kol dhe me datë 12.01.2021 me objekt "Rikonstruksion Bujtinash për Agroturizëm", lidhur midis sipërmarrësit "ZDRAVA" SHPK dhe investitor "Z. A.P", me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TV Sh	
	Certifikatë i marrje e në dorëzim të punimeve me datë 18.09.2022			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 16.05.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga investitor "Z. A. P" për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës "Rikonstruksion Bujtinash për Agroturizëm", data e fillimit të kontratës 12.01.2021 data e mbarimit të punimeve të kontratës 18.03.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxxx	me TV Sh	xxxxx
	Faturë tatimore nr.651 datë 15.03.2022, "ZDRAVA" SHPK			
	Faturë tatimore nr.732 datë 15.03.2022, "ZDRAVA" SHPK			

17	Kontratë Sipërmarrje me nr. 55 Rep, nr. 41 Kol dhe me datë 06.01.2023 me objekt “ <i>Projekt restaurimi, përshtatje dhe rijetëzimi i banesës kategori II, me kod arkive G-071, pronë e Z. R.K., Lgjia Goricë, Berat</i> ”, lidhur midis sipërmarrësit "ZDRAVA" SHPK dhe Znj. A. K., me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh			
	Leje ndërtimi nr. 5087/4 prot., datë 18.10.2022			
	Vendim 471, datë 05.10.2022 nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale			
	Certifikat për vërtetim pronësie nr. 1456523			
	Kartela e pasurisë së palujtshme kodi unik 8502035145			
	Harta treguese e regjistrimit			
	Kontratë huapërdorje me nr. Rep 2738 nr. Kol 1270 me datë 15.12.2021, e lidhur ndërmjet huadhënënsit Z. R. K dhe Znj. L. K dhe huamarrësit Znj. A. K			
	Kontratë me nr. 745/10 prot., datë 27.12.2022 me objekt “ <i>Projekt restaurimi, përshtatje dhe rijetëzimi i banesës kategori II, me kod arkive G-071, pronë e Z. R.K., Lgjia Goricë, Berat</i> ”, lidhur midis Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rurl dhe përfituesit Znj. A.K, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxx		
	Certifikatë përdorimi me nr. 2955/4 prot., me datë 11.07.2023			
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi me datë 02.06.2023			
Formular vlerësimi lëshuar nga ainvestitor "Znj. A. K" për operatorin ekonomik "ZDRAVA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Projekt restaurimi, përshtatje dhe rijetëzimi i banesës kategori II, me kod arkive G-071, pronë e Z. R.K., Lgjia Goricë, Berat</i> ”, data e fillimit të kontratës 12.01.2023 data e mbarimit të punimeve të kontratës 05.05.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK, Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: PO	xxxx	me TV Sh	xxxxxxx	

	Faturë tatimore nr.378/2023 datë 30.05.2023, “ZDRAVA” SHPK			
				XXXXXX
	VL Fondit Limit	176,101,389.98	pa TV Sh	
	1 OBJK 50%	88,050,694.99	pa TV Sh	
	Shumatore punimesh 200% VI FL	352,202,779.96	pa TV Sh	

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik *“ZDRAVA” SHPK*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimes, *“ZDRAVA” SHPK* ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga ankimuesi, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara prej tij, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme, të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (*ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës*), komponenti vlerë (*lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), si dhe komponentit natyrë e ngjashme (*i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre*).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar, se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare, sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit,

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme, mori në shqyrtim vetëm këtë kontratë:

1.- Kontratë me nr. 3224 prot., datë 15.12.2020, me objekt “Rindërtim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & “ZDRAVA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë 660,449,463 lekë pa TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë të përkohshme në dorëzim të punimeve, kontratë bashkëpunimi të BOE me prokurë tëposaçme dhe fatura tatimore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për Kontratë me nr. 3224 prot., datë 15.12.2020 me objekt “Rindërtim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “ZDRAVA” SHPK, referuar kontratës së bashkëpunimit me nr. rep 2952 nr.kol 1119, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & “ZDRAVA” SHPK më datë 11.08.2020, ku operatori ekonomik “BAJRAMI N” SHPK ka realizuar 49% të punimeve, të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK ka realizuar 51% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratën e sipërcituar, pasi kjo kontratë i përmbush të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që është brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që ka objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratën e sipërcituar, e cila i përmbush të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e vlerës së realizuar së kontratës, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK, rezulton, se janë në vlerën xxxxx lekë pa TVSH, në raport me % e pjesëmarrjes (51%), sipas kontratës së bashkëpunimit ndërmjet BOE, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, për të cilën ky operator ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit, për përmbushjen e kriterit 2.3.1/a.

Sa më sipër, nga përlllogaritja e kryer nga Komisioni, për kontratën e ngjashme të marrë në shqyrtim të dorëzuar nga operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK, konstaton se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është xxxxxx lekë pa TVSH ose xxxxx lekë me TVSH, duke tejkalluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*FL 176,101,389.998 pa TVSh * 50%= 88,050,694.99 lekë pa TVSh*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga

data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK.

Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet, se operatori ekonomik ankimes ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, nisur nga arsyetja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Pra, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes "ZDRAVA" SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 332,102,089 (treqind e tridhjetë e dy milion e njëqind e dy mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke tejkaluar vlerën punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet ($FL\ 176,101,389.998\ pa\ TVSh * 50\% = 88,050,694.99\ lekë\ pa\ TVSh$) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duke e përmbushur këtë kriter. Rrjedhimisht, ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK.

Duke iu referuar arsyes së skualifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ku është cituar se: "*Shoqëria "ZDRAVA" ShPK me dokumentacionin e paraqitur nuk provoni se keni realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm si anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim pasi në dokumentin e paraqitur Formular Vlerësimi për objektin "Rindertimi i njesive të banimit në ndertesa (pallate) për zone e re për zhvillim Kavaje..." ju jeni vlerësuar për realizim jo të mirë të punimeve gje që nuk tregojnë përmbushjen me sukses të kontratës, duke mos plotësuar kërkesat e VKM 285, datë 19.05.2021, neni 39 pika 5 dhe neni 88, dhe duke mos plotësuar pikën 2.3.1 a) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të përcaktuara në dokumentat e tenderit., Komisioni iu drejtua me shkresat e nr. 546/4 prot., datë 25.04.2024 dhe me nr. 546/6 prot., datë 24.05.2024, autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për të dhënë informacion dhe interpretim mbi këtë vlerësim për këtë kontratë të dorëzuar nga operatori ekonomik "ZDRAVA" SHPK.*

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka kthyer përgjigje më anë të shkresave me nr. 1558/3 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 546/8 prot., datë 04.06.2024 dhe me shkresën me nr. 1558/1 prot., datë 24.05.2024 protokolluar me tonën me nr. 546/7 prot., datë 27.05.2024, ku informon ndër të tjera se: *“Ne përgjigje të shkresave tuaj me Nr. 546/4/2 prot., date 25.04.2024, protokolluar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit me Nr. 1558/2 prot, date 29.04.2024, ju informojme si më poshtë: Siç e dini tashme, Fondi Shqiptar i Zhvillimit si një organizatë zhvillimore jofitimprurese, e cila ushtron veprimtarinë e saj bazuar në ligjin Nr.10130, dt. 11.05.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" është në rolin e agjencisë zbatuese të projekteve të ndryshme prioritare të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, projekte të cilat janë në funksion të zhvillimit të zonave të ndryshme në nivel rajonal dhe vendor. Në këtë kuadër FSHZH ishte caktuar si agjenci zoatuese edhe për programin e Rindertimit pjesë e të cilit është edhe kontrata që ju i bëni referencë. Ne vijim, sipas përcaktimit të nenit 39 të VKM Nr. 285, date 19.5.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", në vendosjen e kërkesave të vecanta për kontratat për punë publike, autoritetet apo entet kontraktore, si dëshmi për përvojën e mëparshme, mund të kërkojnë vërtetime të leshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në këtë kuadër, Agjencia e Prokurimit Publik, si autoriteti rregullator në vend për sistemin e prokurimit publik, ka miratuar dokumentet standarde të prokurimit për punët publike, ku në vecanti ka përfshirë Shtojcën 9 - Formular Vleresimi (procedure e hapur - punë). Nga shqyrtimi i kujdesshëm i këtij dokumenti vërehet se APP ka përcaktuar që ky formular të shoqërohet me Aktin e Kolaudit dhe situacionet përkatëse. Po ashtu, përveç rubrikave ku saktësohen vlera, afati, përmbushja apo jo, etj. formulari standart përmban edhe rubrikën "Vleresimi", rubrike të cilat kërkojnë të plotësohen "me fjalë" nga Autoriteti/Enti Kontraktor. Në këtë rast, në lidhje me referencën specifike, Autoriteti Kontraktor, në marrëdhëniet e tij kontraktuale me operatorin ekonomik në fjalë, ka hasur probleme jo vetëm me aspektet menaxheriale të kontratës, por edhe me probleme të perseritura lidhur me afatin dhe cilësinë e punimeve, riparimet e perseritura të defekteve si gjatë zbatimit të kontratës ashtu edhe gjatë periudhës së garancisë, mosrespektimit të standardeve medimore, masat e sigurisë dhe shëndetit, komunikimit dhe aspekte të tjera të ngjashme dhe si rezultat, vleresimi i përgjithshëm i dhënë ishte "jo i mirë" Në përgjithësi, referencat (formularët e vleresimit) luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e përziejdhjes së kontraktorit, duke ofruar njohuri të vlefshme që informojnë vendimet për vlerim/angazhim/kontraktim dhe kontribuojnë në rezultate të suksesshme të projektit. Leshimi i referencave (formular vleresimi) për një kontraktor të mëparshëm shërben për disa gillime, ndër të cilat konsiderojmë se janë: 1. Konfirmimi i Afësive dhe Përvojes: Referencat ndihmojnë në konfirmimin/verifikimin e aftësive, përvojes dhe ekspertizës së kontraktorit. Ato u ofrojnë autoriteteve/enteteve kontraktor apo punëdhënësve njohuri mbi aftësitë e kontraktorit dhe performancën e tij të mëparshme në projekte të ngjashme. 2. Vleresimi i Cilësisë së Punës: Referencat lejohen autoritetet/entet kontraktore ose punëdhënësit të vlerësojnë cilësinë e punës së kontraktorit. Ato mund të tregojnë për kujdesin ndaj detajeve të kontraktorit, përmbushjen e specifikimeve të projektit dhe aftësinë për të ofruar rezultate sipas*

prishmerive. 3. Vleresimi i Profesionalizmit dhe Komunikimit: Referencat mund të hedhin dritë mbi profesionalizmin e kontraktorit, aftësitë e tij në komunikim dhe aftësinë për të bashkëpunuar efektivisht me autoritetet/entet kontraktore, anëtarit e ekipeve apo/dhe palët e interesuara (njësi të vetëqeverisjes vendore, përfitues direkt, etj). Këto informacione ndihmojnë në vlerësimin e mënyrës së integritetit të kontraktorit në ekipet e projektit dhe në ndërvëprimin me autoritetet/ entet kontraktore. 4. Zbutjen e rrezikut (Risk mitigation): Duke kërkuar dhe marrë referencat, autoritetet/entet kontraktore ose punëdhënësit mund të reduktojnë rrezikun e lidhur me kontraktimin/punësimin e një kontraktori. Njohja për performancën e mëparshme të kontraktorit, besueshmërinë dhe aftësinë për të përballuar sfidat mund të informojnë vendimet për kontraktim/punësim dhe të zvogelone mundësinë e pengesave apo mospërbushjes së projektit. 5. Ndërtimi i Besimit: Referencat pozitive ndërtone besim në aftësitë dhe përshtatshmërinë e kontraktorit për objektin e punës së projektit. Ato u rikthejnë autoritetet/entet kontraktore ose punëdhënësit sigurinë se po marrin një vendim të arsyeshëm duke përzgjedhur dhe kontraktuar shërbimet e duhura të një kontraktori. Për sa më sipër, duke pasur parasysh se ligjvënisi dhe autoriteti rregullator kanë përcaktuar kërkesën për referencat (formular vlerësimi, të shqyrtuar me akte kolaudimi, ku janë përfshirë minimalisht kërkesat për vlerën dhe afatin e përfundimit të kontratës, natyrën e punës së bërë, si dhe situacionet përkatëse, deduktohet se rubrika "Vlerësimi" i lihet autoritetet/entet kontraktore të plotësohet. Në këtë plotësim autoritetet/entet kontraktore kanë parasysh pikërisht vlerësimin e cilësive të punimeve të kryera, pra minimalisht gënjeshmërinë e këtyre punimeve dhe mospasjen e nevojës për përsëritjen dhe riberjen e këtyre punimeve, jo vetëm gjatë periudhës së kontratës por edhe për mosberjen e disahershme të riparimeve të të njëjtave punime, vlerësimin e profesionalizmit dhe komunikimit gjatë afatit të kontratës dhe përbushjen e këtij afati sipas grafikut të kërkuar për të dorëzuar në kohë veprën publike, apo shmangien e rrezikut të vonësës së dorëzimit të përfituesit direkt të kësaj vepre publike duke shmangur nisjen apo nxitjen e problematikave sociale përcaktuar atyre ekonomike, si dhe aspekte të tjera të cilat nuk arrihet të artikulojnë qartësisht në dokumente si akti i kolaudimit apo situacionet. Për çdo informacion shtesë apo sqarime të mëtejshme, ju lutem mos nguroni të na kontaktoni.

III.1.7. Në lidhje me këtë kontratë me nr. 3224 prot., datë 15.12.2020, me objekt "Rindërtim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë" Objekti 2.2 dhe 2.3", lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "BAJRAMI N" SHPK & "ZDRAVA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë 660,449,463 lekë pa TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë të përkohshme në dorëzim të punimeve, kontratë bashkëpunimi të BOE me prokurë të posaçme dhe fatura tatimore, Komsioni konstatoi, se në Formularin e Vlerësimit nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, është vlerësuar me "Realizim jo i mirë i punimeve".

Në nenin 76 pika 3 gërma "e" të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar parashikohet se: 3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përbushjen e një kriteri thelbësor të një

kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.”

Së pari, për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në dy momente, atë të intepretimit të nenit 76 pika 3 gërma “e” të ligjit për prokurimin publik, por gjithashtu edhe në qëndrimet e mbajtuara në intepretim të neneve të Direktivës 24/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Për Prokurimin Publik”, në kushtet kur vetë ligji i prokurimit publik i Shqipërisë është i përafuar me direktivën e Bashkimit Evropian.

Së pari, referuar metodave të intepretimit gjuhësor dhe atij teleologjik të nenit 76 pika 3 gërma “e” të ligjit të prokurimit publik, rezulton, se është në kompetencën e autoritetit kontraktor të skualifikojë nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: nëse ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare **që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.**

Pra, ligjvënësi ka parashikuar qartësisht diskrecionin e autoritetit kontraktor për të skualifikuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik një operator ekonomik, për mosrealizim të suksesshëm të një kontrate të mëparshme me po të njëjtin autoritetit kontraktor ose me autoritete të tjera kontraktore.

Ky diskrecion i autoritetit kontraktor është i kufizuar nga ligjvënësi në disa raste, së pari:

a) **ka shfaqur mangësi të rëndësishme**

ose

b) **ka shfaqur mangësi të vazhdueshme**

këto mangësi duhet të jenë të lidhura me përmbushjen e një kriteri thelbësor dhe që kanë çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton, se ka dorëzuar kontratën me nr. 3224 prot., datë 15.12.2020, me objekt “Rindërtim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “BAJRAMI N” SHPK & “ZDRAVA” SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë 660,449,463 lekë pa TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë të përkohshme në dorëzim të punimeve, kontratë bashkëpunimi të BOE me prokurë të posaçme dhe fatura tatimore.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton, se në certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit datë 31.12.2021, të nënshkruar nga përfaqësues të kontraktorit, mbikëqyrësit, kolaudatorit NjVV dhe FSHZH deklarohet se: “Punimet në objekt janë realizuar sipas projektit dhe preventivit të kontratës”.

Referuar procesverbalit të kolaudimit, datë 17.12.2021, të nënshkruar nga kontraktori, mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori deklarohet se:

Në seksionin 10 Verifikimet mbi zbatimin e projektit në fakt dhe gjendja aktuale e tyre deklarohet se: Gjatë periudhës së kaaloudimit të punimeve janë kryer vizita në objekt për të

verifikuar dhe konfirmuar në vend zbatimin e këtij projekti. Janë bërë disa sondazhe mbi punimet beton dhe beton/arme, punime suvatimi, punime shtresash, punime murature. Nuk ka rezultuar asnjë devijim në princip nga projektet e hartuar dhe të miratuara për objektet që kanë përfunduar.

Në seksionin 13 Zbatimi i projektit, të dhënat nga majtet faktike në vend, seksioni Cilësia e punimeve, deklarohet se: “Cilësia e punimeve: Nga kontrolli faktik rezulton se punimet e ndërtimit të objektit “Rindërtim i njërive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, janë cilësorë dhe pa asnjë problem teknik”.

Në konceptim klasik, miratimi i situacioneve përfundimtare dhe kolaudimi i objektit/ve është një veprim juridik, në kuptim të nenit 79 të Kodit Civil, ku parashikohet se: “Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile. Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.” Referuar materialeve të administruara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se krahas dokumentacionit si më sipër cituar, nga ana e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues është dorëzuar edhe Procesverbal Kolaudimi datë 17.12.2021, mbi kolaudimin e punimeve të objektit “Rindërtim i njërive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonën e re për zhvillim Kavajë, Paketa C, njësia administrative Kavajë, Bashkia Kavajë” Objekti 2.2 dhe 2.3”, mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “BOE Studio-Rebus SHPK & “47 EK 79 & ILIRIADA PKS “SHPK” ShPK. KPP sqaron, se projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e Shqipërisë, kontrollohen dhe disiplinohen në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar. Të gjithë shoqëritë e mësipërme, si kolaudatori ashtu edhe mbikëqyrësi i punimeve, i nënshtrohen një rregullimi dhe licencimi specifik, referuar edhe legjislacionit sektorial. Të gjithë personat e mësipërm, në cilësinë e personave juridikë, mbajnë përgjegjësi ligjore, për aktet e lëshuara në zbatim të ligjit për disiplinimin e punimeve të ndërtimit. Gjithashtu, KPP vlerëson, se referuar momentit procedural të shqyrtimit të ankesës, nuk ka asnjë akt për shfuqizimin e Procesverbalit të kolaudimit të mësipërm, lëshuar nga organet administrative, gjyqësore, ose vetëlëshuesit e aktit.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se referuar shkresave me nr. 1558/1 Prot., datë 24.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 546/7 prot., datë 27.05.2024 me objekt: “Kthim - përgjigje”, dhe me nr. 1558/3 Prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 546/8 prot., datë 04.06.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje”, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, deklarohet, se punimet janë realizuar jo mirë, por ndërkohë referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se vetë përfaqësuesit e autoritetit kontraktor (FSHZH) kanë marrë në dorëzimin objektin dhe nuk ka asnjë reklamim për punime të pakryera në përputhje me projektin apo mungesë cilësie. Gjithashtu, nuk rezulton e dokumentuar, se ndaj operatorit ekonomik Zdrava ShPK janë marrë masa nga ana e autoritetit kontraktor (FSHZH) në kuadër të procesit të menaxhimit të kontratës, apo të ketë ndërprerje të kontratës mes palëve. KPP gjykon, se është në kompetencë të autoritetit kontraktor në cilësinë e mbikëqyrësit dhe menaxhuesit të kontratës,

të lëshojë vërtetim në lidhje me performancën e kontraktorëve në procedurat e prokurimit publik, por ndërkohë nga ana tjetër, ligjvënësi ka parashikuar kushte të posaçme të skualifikimit të operatorëve ekonomikë nga procedura e prokurimit, referuar nenit 76 pika 3 gërma e. Këto kushte janë kumulative, ku thelbësorja lidhet me përfundimin e kontratës publike, pra mangësitë thelbësore në realizim ose të vazhdueshme, të kriterëve thelbësore, të kenë çuar në përfundimin e kontratës publike, gjë që nuk është e provuar në rastin objekt - shqyrtimi.

Gjithashtu KPP gjykon, t'i drejtohet për një interpretim të drejtë të nenit 76 pika 3 gërma "e" të LPP, të drejtës komunitare, si edhe vendimmarrjes së Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës dhe "Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Ndërmjet Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë", neni 70 i së cilës parashikon se: "Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet".

Komisioni i Prokurimit Publik i referohet për interpretim të drejtë të parashikimit të mësipërm (nenit 76 pika 3 gërma "e" të LPP,) nenit 57 "Arsyet e Përjashtimit" pika 4 gërma "g" të Direktivës 24/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Për Prokurimin Publik" në të cilën parashikohet, se "Autoritetet kontraktuese mund të përjashtojë ose mund të kërkohet nga Shtetet Anëtare për të përjashtuar nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi çdo operator ekonomik në ndonjë nga situatat e mëposhtme: g) ku operatori ekonomik ka treguar mangësi të mëdha apo të vazhdueshme në kryerjen e një kërkesë thelbësore në bazë të një kontrate të mëparshme publike, një kontratë paraprake me një subjekt kontraktues ose një kontratë koncesioni paraprak të cilat çuan në ndërprerjen e hershme të kësaj kontrate paraprake, dëmet ose sanksione të tjera të krahasueshme;

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kuadri ligjor në fushën e prokurimeve, parë kjo edhe në dritën e interpretimit të Direktivës 24/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Për Prokurimin Publik" i jep mundësinë autoritetit kontraktor të përjashtojë operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, kur vërtetohet, se këto të fundit kanë treguar mangësi dhe probleme të vazhdueshme në zbatimin e kontratave të mëparshme.

Inter allia dhe mutatis mutandis, Gjykata Europiane e Drejtësisë, në vendimin nr. C-465/11, Forposta SA, ABC Direct Contact sp. z o.o. kundër Poczta Polska SA, ndër të tjera është shprehur se *"Për më tepër, legjislacioni kombëtar në rastin konkret përcakton parametrat (rastet) që lejojnë autoritetit kontraktues në fjalë që të përjashtojë një operator ekonomik nga një procedurë të sapo ndërmarrë për dhënien e një kontrate për shkak të sjelljes së mëparshme të këtij operatori, duke mos i lënë autoritetit kontraktues fuqinë për të vlerësuar, mbi një bazë rast pas rasti, serioziteti i sjelljes të pretenduar si të gabuar të këtij operatori në kryerjen e kontratës së mëparshme. Si rrjedhim, është e qartë se rregullat kombëtare në fjalë në procedimin kryesor nuk ndjekin thjesht kornizën e përgjithshme për zbatimin e pikës (d) të paragrafit të parë të nenit 45 (2) të Direktivës 2004/18, por i jep të drejtën autoritetit kontraktor të vendosë kërkesat dhe konkluzionet e detyrueshme që të nxirren automatikisht në rrethana të caktuara, duke tejkaluar lirinë e dhënë nga Shtetet*

Anëtare, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 45 (2) të kësaj direktive, duke specifikuar kushtet zbatuese për rastet e përjashtimit të përcaktuar në pikën (d) të paragrafit të parë të nenit 45 (2) me lidhje për ligjin e BE.

Në dritën e të gjitha konsideratave të mësipërme, përgjigja për pyetjen e parë është se pika (d) të nënparagrafit të parë të nenit 45 (2) të Direktivës 2004/18 duhet të interpretohet si përjashton legjislacionin kombëtar i cili siguron se një situatë e shkelje të rëndë profesionale, e cila çon në përjashtimin automatik të operatorit ekonomik në fjalë nga një procedurë për dhënien e një kontrate publike në progres, lind atëherë kur autoriteti kontraktues në fjalë ka anuluar, përfunduar ndërprerë një kontratë publike me të njëjtin operator ekonomik në rrethana për të cilët operatori ekonomik është përgjegjës, kur anulimi, përfundimi ose heqja dorë kanë ndodhur në periudhën trevjeçare përpara se procedura është iniciuar dhe vlera e pjesës jo-kryer të kontratës arriti në të paktën 5% të vlerës së përgjithshme të kontratës.”

Sa më sipër, edhe GJED ka mbajtur qëndrim në interpretim të direktivës, se autoriteti kontraktor do të ndodhet në kushtet e përjashtimit nga gara në një procedurë prokurimi publik referuar përmbushjes së një kontrate mëparshme, **kur autoriteti kontraktues në fjalë ka anuluar, përfunduar ndërprerë një kontratë publike me të njëjtin operator ekonomik në rrethana për të cilët operatori ekonomik është përgjegjës, kur anulimi, përfundimi ose heqja dorë kanë ndodhur në periudhën trevjeçare përpara se procedura është iniciuar dhe vlera e pjesës jo-kryer të kontratës arriti në të paktën 5% të vlerës së përgjithshme të kontratës.”** Ndërkohë, referuar dokumentacionit të administruar, nuk rezulton e provuar edhe nga komunikimi shkresor me autoritetin kontraktor (Fondin Shqiptar të Zhvillimit), se operatori ekonomik Zdrava SHPK, ndodhet në kushtet e mësipërme.

Sa më sipër, KPP konstaton, se në dokumentacionin teknik, bashkëngjitur kontratës së mësipërme, është cilësuar nga grupi i ekspertëve (kolaudatori dhe mbikqyrësi i punimeve për këtë vepër publike), që nga *mbikqyrësi i punimeve janë kryer kontrole periodike për zbatimin e projektit dhe të cilësisë së punimeve sipas K.T.Z-së në fuqi, të cilat janë regjistruar në librin e objektit. Është konstatuar se punimet janë kryer me cilësi të mirë dhe sipas specifikimeve të projektit.Ndërtimi i objektit është realizuar nga data 28.01.2021 deri në datën 29.09.2021.*

Gjithashtu, autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në shkresat kthim - përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion dhe interpretim të formularit të vlerësimit realizim jo i mirë i punimeve të kërkuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, nuk ka bashkëngjitur asnjë dokumentacion mbështetës apo provues mbi përgjigjen për sqarim për sa cituar dhe pretenduar nga ky i fundit, më lart.

Referuar gërmës “e” të pikës 3 të nenit 77 “Kriteret detyruese për skualifikim” të LPP, sipas së cilës parashikohet se: “e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji”, pozitat e operatorit ekonomik “ZDRAVA” SHPK nuk është në kushtin e larpërmendur.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton se plotëson kriterin 2.3.1/a të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik “Ina” ShPK, nuk plotëson Kriterin për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1. të Kriteve të Vecante në DST për objektin “Ndërhyrje në muze dhe objekte monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela” për sa i përket “Përvojës së suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë vitet të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht, ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme sipas kriterit a- me një kontratë të vetme në vlerën 50% të fondit limit (88,050,694.99 lekë pa TVSh), pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme në këtë vlerë dhe as sipas kriterit b) në vlerën e dyfishit të fondit limit (352,202,779.96) me shumë kontrata, pasi kontratat e ngjashme nuk arrijnë vlerën e kërkuar. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Sa më sipër, Operatori Ekonomik “Ina” ShPK skualifikohet!, Komisioni i*

Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, i dokumenteve standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, *plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- *Kontratën/at e Sipërmarrjes*
- *Fature tatimore e situacionit përfunditar*
- *Situacioni përfundimtar*
- *Akt - kolaudimi;*

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “INA” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

	INA SHPK			
1	Kontratë me nr. 114 prot., datë 06.10.2021 me objekt “Rikonstruksion i Terreneve Sportive Plug”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor K.F. Lushnja 1930 ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar me nr. 20 prot., datë			

	29.01.2022			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 22.02.2022			
	Akt - kolaudimi me datë 22.02.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor K.F. Lushnja 1930 ShA, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i Terreneve Sportive Plugs”, data e fillimit të kontratës 06.10.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 21.01.2022, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përbushur: PO	xxxxxx	me TVSh	xxxxx
2	Kontratë me nr. 53 prot., datë 13.01.2020 me objekt “Rikonstruksion i zyrave ekzistuese”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "Al-Asfalt" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjetës Kanalizime Durrës ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh		me TVSh	
	Kontratë bashkëpunimi me nr. Rep. 4504, Kol., 2565/1, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "Al-Asfalt" SHPK me datë 26.09.2019, ku operatori ekonomik “INA” SHPK do të realizojë 50% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “Al-Asfalt” SHPK do të realizojë 50% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur,	xxxxx	pa TVSh	
	Prokurë e posaçme me nr. Rep 4505 Kol./, 2566/1 me datë 26.09.2019			
	Situacion përfundimtar me nr. 20 prot., datë 29.01.2022			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 817/1 prot., me datë 04.05.2020			
	Akt - kolaudimi me nr. 817 prot., me datë 04.05.2020			
	Akt dorëzimi përfundimtar me nr. 634/1 prot., datë 18.02.2022			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Durrës ShA, për bashkimin e operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "Al-Asfalt" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i zyrave ekzistuese”, data e fillimit të kontratës 13.01.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 13.04.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "Al-Asfalt" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxx	pa TVSh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 22 datë 05.03.2020, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 223 datë 06.04.2020, “INA” SHPK			
3	Kontratë me nr. 1692 prot., datë 30.04.2018 me objekt “Rikonstruksion i objekteve shkollore + terrene”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 11.10.2018			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i objekteve shkollore + terrene”, data e fillimit të kontratës 14.05.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 06.09.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: E përmbushur shumë mirë	xxxxxxx	me TVSh	
4	Kontratë me nr. 3905/7 prot., datë 07.12.2018 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar me nr. 4123/12 prot., datë 21.05.2019		me TVSh	xxxxxxx
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 4123/15 me datë 30.05.2019			
	Akt - kolaudimi me nr. 4123/14 prot., me datë 30.05.2019			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rikonstruksion i pjesshëm i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Durrës”</i> , data e fillimit të kontratës 07.12.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 24.04.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
	Kontratë me nr. 2061/21 prot., datë 28.01.2019 me objekt <i>“Ndërhyrje për përshtatjen infrastrukturore të ambjenteve të UPT Loti 1 “Ndërhyrje për përshtatje infrastrukturore të ambjenteve të FIN”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar me nr. 20 prot., datë 29.01.2022			xxxxxxx
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 06.05.2019			
5	Akt - kolaudimi me datë 06.05.2019			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoritetit kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Ndërhyrje për përshtatjen infrastrukturore të ambjenteve të UPT Loti 1 “Ndërhyrje për përshtatje infrastrukturore të ambjenteve të FIN”</i> , data e fillimit të kontratës 13.03.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 18.04.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
6	Kontratë me nr. 1528/28 prot., datë 26.03.2018 me objekt <i>“Rikonstruksion në ambientet e brendshme të njëjësive të UPT, Loti 1 Riparime dhe rinovime në ambientet e brendshme të Universitetit Politeknik të Tiranës”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			

	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 04.06.2018			
	Akt - kolaudimi me datë 04.06.2018			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion në ambientet e brendshme të njërive të UPT, Loti 1 Riparime dhe rinovime në ambientet e brendshme të Universitetit Politeknik të Tiranës”, data e fillimit të kontratës 26.03.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 10.05.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
	Kontratë me nr. 2582/8 prot., datë 10.10.2018 me objekt “Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kolonjë”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar me nr. 2852/21 prot., datë 19.02.2018			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 28.12.2018			
7	Akt - kolaudimi me nr. 2852/23 me datë 28.12.2018			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kolonjë”, data e fillimit të kontratës 05.11.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 19.12.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
8	Kontratë me nr. 5261/7 prot., datë 02.10.2020 me objekt “Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ministria e Drejtësisë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve			

	Akt - kolaudimi 12.03.2021			
	vërtetim realizimi me nr. 6466/1 me datë 11.01.2022			
	Formular vlerësimi nga autoriteti kontraktor Ministria e Drejtësisë, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”</i> , data e fillimit të kontratës 02.10.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 08.01.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PUnimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 42 datë 31.12.2020, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 37 datë, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 7/2021 datë 07.04.2021, “INA” SHPK			
9	Kontratë me nr. 3151/10 prot., datë 02.11.2018 me objekt <i>“Rikonstruksion i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Fier”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar me nr. 3151/24 prot., datë 24.12.2018			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 3151/26 me datë 04.01.2019			
	Akt - kolaudimi me datë 28.12.2018			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rikonstruksion i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Fier”</i> , data e fillimit të kontratës 05.11.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 24.12.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: Punimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
10	Kontratë me nr. 2601/8 prot., datë 26.09.2018 me objekt <i>“Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Përmet”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	

	Situacion përfundimtar me nr. 2601/20 prot., datë 14.11.2018.			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 2601/23 me datë 12.12.2018			
	Akt - kolaudimi me datë 12.12.2018			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>"Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Përmet"</i> , data e fillimit të kontratës 01.10.2018, data e mbarimit të punimeve të kontratës 14.11.2018, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: Punimet janë realizuar me cilësi shumë të mirë dhe sipas projektit e specifikimeve teknike. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
11	Kontratë me datë 04.02.2021 me objekt <i>"Riparim/Përforcim i Shkollës 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot , Kurbin"</i> , lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TVSh	xxxxxxx
	Kontratë bashkëpunimi me nr. Rep. 9214, Kol., 1846, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK me datë 11.12.2020,			
	Prokurë e posaçme me nr. Rep 9215 Kol./, 1847 me datë 11.12.2020			
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë			
	Akt - kolaudimi me datë 31.01.2022			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor UNDP, për bashkimin e operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK për objektin e kontratës <i>"Riparim/Përforcim i Shkollës 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot , Kurbin"</i> , data e fillimit të kontratës, data e mbarimit të punimeve të kontratës, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK, Vlerësimi:			
	Faturë tatimore nr. 13/2021 datë 10.08.2021, "INA" SHPK			

12	Kontratë me nr. 9488/3 prot., datë 07.03.2019 me objekt <i>“Rehabilitimi i qendrës Administrative Baldushk (Rikonstruksion i godinës së Njësisë, shtëpisë kulturës dhe sheshit”</i> , lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 30.06.2020			
	Akt - kolaudimi			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rehabilitimi i qendrës Administrative Baldushk (Rikonstruksion i godinës së Njësisë, shtëpisë kulturës dhe sheshit”</i> , data e fillimit të kontratës 07.03.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 06.02.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: PPunimet janë kryer konform kontratës, kushteve teknike të zbatimit dhe brenda afatit. E përmbushur: PO	xxxxx	me TVSh	xxxxxx
	Faturë tatimore nr. 40 datë 01.09.2019, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 24 datë 25.04.2020, “INA” SHPK			
13	Kontratë me nr. 10057/6 prot., datë 19.08.2019 me objekt <i>“Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në rrugën "Bedri Karapici", "Hamdi Pepa”</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi 13.01.2020			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës <i>“Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në rrugën "Bedri Karapici", "Hamdi Pepa”</i> , data e fillimit të kontratës 19.08.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 15.11.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, kushteve teknike të zbatimit dhe brenda afatit. E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
	Faturë tatimore nr. 20 datë 13.01.2020, “INA” SHPK			

14	Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugës "Shënmhill", Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me nr. 376/11 prot me datë 08.07.2019			
	Akt - kolaudimi me nr. 376/10 prot., datë 08.07.2019			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion i rrugës "Shënmhill", Bashkia Durrës”, data e fillimit të kontratës 07.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 27.06.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, kushteve teknike të zbatimit dhe brenda afatit. E përmbushur: PO	xxxxxxxxx	me TVSh	
	Faturë tatimore nr. 19 datë 03.06.2019, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 29 datë 02.07.2019, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 30 datë 02.07.2019, “INA” SHPK			
15	Kontratë me datë 05.04.2022 me objekt “Rriparim/Rikonstruktimin e Kopshtit Nr. 41, në Bashkinë Tiranë”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxx	me TVSh	xxxxxx
	Kontratë bashkëpunimi me nr. Rep. 9201, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK me datë 05.12.2022,			
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 15.09.2023			
	Akt - kolaudimi			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor UNDP, për bashkimin e operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK për objektin e kontratës “Rriparim/Rikonstruktimin e Kopshtit Nr. 41, në Bashkinë Tiranë”, data e fillimit të kontratës, data e mbarimit të punimeve të kontratës, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK, Vlerësimi:			
	Faturë tatimore nr. 16/2023 datë 17.05.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 20/2023 datë 01.06.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 28/2022 datë 16.12.2022, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 3/2023 datë 15.09.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 4/2023 datë 17.03.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 7/2023 datë 04.04.2023, “INA” SHPK			
16	Kontratë me datë 18.02.2022 me objekt “Rriparim/Rikonstruktimin e Shkollës 26 Nëntori, në Bashkinë Tiranë”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	xxxxxx
	Kontratë bashkëpunimi me nr. Rep. 9201, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK me datë 05.12.2022,			
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 29.02.2024			
	Akt - kolaudimi 21.02.2024			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor UNDP, për bashkimin e operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK për objektin e kontratës “Rriparim/Rikonstruktimin e Shkollës 26 Nëntori, në Bashkinë Tiranë”, data e fillimit të kontratës, data e mbarimit të punimeve të kontratës, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK, Vlerësimi:			
Faturë tatimore nr. 1/2023 datë 05.09.2023, “INA”				

	SHPK			
	Faturë tatimore nr. 12/2023 datë 06.05.2023, "INA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 20/2023 datë 17.11.2023, "INA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 26/2023 datë 27.07.2023, "INA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 27/2022 datë 16.12.2022, "INA" SHPK			
	Faturë tatimore nr. 7/2024 datë 29.02.2024, "INA" SHPK			
17	Kontratë me nr. 29348/6 prot., datë 24.02.2020 me objekt "Ndërtim dhe Rikonstruksion linjash kanalizimi në Njësitë1,2,3,4,5 dhe Drejtorinë Rajonale", lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Akt - kolaudimi 07.09.2020			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ShA, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës "Ndërtim dhe Rikonstruksion linjash kanalizimi në Njësitë1,2,3,4,5 dhe Drejtorinë Rajonale", data e fillimit të kontratës 29.04.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 28.07.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: Punimet janë kryer konform kontratës, kushteve teknike të zbatimit dhe brenda afatit. E përmbushur: PO	xxxxxxxxx	me TVSh	
	Faturë tatimore nr. 21 datë 07.09.2020, "INA" SHPK			
18	Kontratë me nr. 3100 prot., datë 26.08.2020 me objekt "Ndërtim i varrezave të qytetit", lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Gramsh, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 31.12.2020			
	Akt - kolaudimi me datë 18.12.2020			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Ndërtim i varrezave të qytetit</i> ”, data e fillimit të kontratës 09.09.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 24.11.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: shumë të mirë E përmbushur: PO	xxxxxxx	pa TVSh	xxxxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 31 datë 21.10.2020, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 39 datë 29.11.2020, “INA” SHPK			
19	Kontratë me nr. 5287 prot., datë 12.10.2022 me objekt “ <i>Rikonstruksion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq, faza 2</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 11.09.2023			
	Akt - kolaudimi me datë 04.09.2023			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Rikonstruksion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq, faza 2</i> ”, data e fillimit të kontratës 12.10.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 10.05.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: shumë të mirë E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	xxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 6/2023 datë 04.10.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 10/2023 datë 25.04.2023, “INA” SHPK			
20	Kontratë me nr. 5252 prot., datë 11.10.2022 me objekt “ <i>Rrjeti i brendshëm ujësjellës</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 21.06.2023			
	Akt - kolaudimi me datë 21.06.2023			

	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Rrjeti i brendshëm ujësjellës</i> ”, data e fillimit të kontratës 11.10.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 12.04.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: shumë të mirë E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	
	Faturë tatimore nr. 1/2023 datë 09.02.2023, “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 25/2023 datë 13.07.2023, “INA” SHPK			
21	Kontratë Sipërmarrje me nr. 253 prot., datë 26.08.2019 me objekt “ <i>Shërbim, riparim i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr.26-27 dhe Nr. 28-29</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	xxxxxxx	me TVSh	
	Situacion përfundimtar			
	Certifikat e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve me datë 27.11.2019			
	Akt - kolaudimi me datë 27.11.2019			
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq, për operatorin ekonomik "INA" SHPK për objektin e kontratës “ <i>Shërbim, riparim i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr.26-27 dhe Nr. 28-29</i> ”, data e fillimit të kontratës 26.08.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 17.11.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik "INA" SHPK, Vlerësimi: shumë të mirë E përmbushur: PO	xxxxxxx	me TVSh	xxxxxxxxxxxx
	Faturë tatimore nr. 41 datë 01....., “INA” SHPK			
	Faturë tatimore nr. 5 datë ...10.2019, “INA” SHPK			
		VL Fondit Limit	176,101,389.98	pa TVSh
	1 OBJK 50%	88,050,694.99	pa TVSh	
	Shumatore punimesh 200% VI FL	352,202,779.96	pa TVSh	xxxxxx

III.2.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që ” 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt - kolaudimi;

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të

provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për përmbushjen e kriterit kualifikues, të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.2.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara prej tij, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor, me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (*ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohor 5 vjecar nga data e njoftimit të kontratës*), komponenti vlerë (*lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra a)-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose b)-punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*), si dhe komponentit natyrë e ngjashme (*i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre*).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor, për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **“INA” SHPK**, Komisioni konstaton, se ky i fundit nuk përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor, për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*FL 176,101,389.998 pa TVSh * 50%= 88,050,694.99 lekë pa TVSh*), që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht, KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik **“INA” SHPK**, për plotësimin e kushtit të dytë *“punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”*.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik **“INA” SHPK**, për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/b të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim vetëm këto kontrata:

1-. Kontratë me nr. 114 prot., datë 06.10.2021 me objekt “Rikonstruksion i Terreneve Sportive Plug”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor K.F. Lushnja 1930 ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim.

2-. Kontratë me nr. 53 prot., datë 13.01.2020 me objekt “Rikonstruksion i zyrave ekzistuese”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "Al-Asfalt" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Durrës ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

3-. Kontratë me nr. 3905/7 prot., datë 07.12.2018 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, Situacion përfundimtar me nr. 4123/12 prot., datë 21.05.2019, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim,

4-. Kontratë me nr. 2061/21 prot., datë 28.01.2019 me objekt “Ndërhyrje për përshtatjen infrastrukturore të ambjenteve të UPT Loti 1 "Ndërhyrje për përshtatje infrastrukturore të ambjenteve të FIN”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, Situacion përfundimtar me nr. 20 prot., datë 29.01.2022, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim,

5-. Kontratë me nr. 5261/7 prot., datë 02.10.2020 me objekt “Rehabilitim emergjent i godinës së Ministrisë së Drejtësisë”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ministria e Drejtësisë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim, dhe fatura tatimore.

6-. Kontratë me datë 04.02.2021 me objekt “Riparim/Përforcim i Shkollës 9-vjeçare "28 Nëntori" Fushë Milot , Kurbin”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

7-.Kontratë me nr. 9488/3 prot., datë 07.03.2019 me objekt “Rehabilitimi i qendrës Administrative Baldushk (Rikonstruksion i godinës së Njësisë, shtëpisë kulturës dhe sheshit”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

8-.Kontratë me datë 05.04.2022 me objekt “Riparim/Rikonstruktimin e Kopshtit Nr. 41, në Bashkinë Tiranë”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

9-.Kontratë me datë 18.02.2022 me objekt “Riparim/Rikonstruktimin e Shkollës 26 Nëntori, në Bashkinë Tiranë”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë "INA" SHPK & "XHENGO" SHPK dhe autoritetit kontraktor UNDP, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

10-.Kontratë me nr. 3100 prot., datë 26.08.2020 me objekt “Ndërtim i varrezave të qytetit”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Gramsh, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

11-. Kontratë me nr. 5287 prot., datë 12.10.2022 me objekt “Rikonstruksion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq, faza 2”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

12-. Kontratë Sipërmarrje me nr. 253 prot., datë 26.08.2019 me objekt “Shërbim, riparim i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr.26-27 dhe Nr. 28-29”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion përfundimtar, akt - kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që është brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontrate të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren, se nga përlllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “INA” SHPK, rezulton se janë në

vlerën xxxxxx lekë me TVSH ose xxxxxxxx lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, është më e vogël se shumatorja e punimeve (200% vl së FL, pra $176,101,389.958 * 200\% = 352,202,779.96$ lekë pa TVSh).* Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim, rezulton, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik "INA" SHPK, rezulton se është xxxxxxxxxx lekë me TVSH ose xxxxxxxxxx lekë pa TVSH, duke mos tejkaluar vlerën prej *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, pra është më e vogël se shumatorja e punimeve (200% vl së FL, pra $176,101,389.958 * 200\% = 352,202,779.96$ lekë pa TVSh),* që duhet të plotësojë ky operator, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, është më e vogël se shumatoria e punimeve (200% vl së FL, pra $176,101,389.958 * 200\% = 352,202,779.96$ lekë pa TVSh).* Rrjedhimisht, ky kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik "INA" SHPK. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Pra, nga përlllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, duke e përlllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik ankimues "INA" SHPK, rezulton, se janë në vlerën xxxxxxxxxx lekë me TVSH ose xxxxxxxxxx lekë pa TVSH, duke mos e tejkaluar vlerën prej *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, është më e vogël se shumatoria e punimeve (200% vl së FL, pra $176,101,389.958 * 200\% = 352,202,779.96$ lekë pa TVSh).*, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërtimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt - shqyrtimi, rezulton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të dëshmojë, se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm nuk përmbushin dhe nuk e

tejkalojnë vlerën prej (200% vl së FL, pra $176,101,389.958 \cdot 200\% = 352,202,779.96$ lekë pa TVSh, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

III.2.8. Në lidhje me kontratat si më poshtë:

1- Kontratë me nr. 10057/6 prot., datë 19.08.2019 me objekt “Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në rrugën "Bedri Karapici", "Hamdi Pepa"”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

2- Kontratë me nr. 112/24 prot., datë 02.05.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugës "Shënmhill", Bashkia Durrës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Këshilli i Qarkut Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

3- Kontratë me nr. 29348/6 prot., datë 24.02.2020, me objekt “Ndërtim dhe Rikonstruksion linjash kanalizimi në Njësitë 1, 2, 3, 4, 5, dhe Drejtorinë Rajonale”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë ShA, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

4- Kontratë me nr. 5252 prot., datë 11.10.2022 me objekt “Rrjeti i brendshëm ujësjellës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik. Punimet në ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim rrugësh dhe ndërtim/rikonstruksion i godinave civile, janë dy kategori punimesh të ndryshme. Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.

Ndërsa në lidhje me kontratat e:

1- Kontratë me nr. 1692 prot., datë 30.04.2018 me objekt “Rikonstruksion i objekteve shkollore + terrene”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

2- Kontratë me nr. 1528/28 prot., datë 26.03.2018, me objekt “Rikonstruksion në ambientet e brendshme të njërive të UPT, Loti 1 Riparime dhe rinovime në ambientet e brendshme të Universitetit Politeknik të Tiranës”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

3- Kontratë me nr. 2582/8 prot., datë 10.10.2018 me objekt “Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Kolonjë”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

4- Kontratë me nr. 3151/10 prot., datë 02.11.2018 me objekt “Rikonstruksion i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Fier”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

5- Kontratë me nr. 2601/8 prot., datë 26.09.2018, me objekt “Rikonstruksion i zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Përmet”, lidhur midis operatorit ekonomik "INA" SHPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh;

Komisioni konstaton, se këto kontrata nuk plotësojnë elementin kohë, pasi nuk janë realizuar gjatë 5 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës së procedurës objekt - prokurimi, objekt - ankimi.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues vërteton nuk se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. **REF-01146-04-12-2024**, me objekt “Ndërrhyrje në muze dhe objekte monumente kulture, rivitalizimi i qendrës së artit Vace Zela”, me fond limit **176,101,389.98** (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e një mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “ZDRAVA” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK, për procedurën e prokurimit më sipër cituar.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ZDRAVA” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INA” SHPK
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Gjergj Mersini
Kryetar		
Jonaid Myzyri		